




Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

Punim avokues

ZGJEDHJET LOKALE TË 17 TETORIT NË VLERËSIM EX-ANTE



Korrik, 2021



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

Koalicioni Demokracia në Veprim është themeluar në vitin 2007 nga 11 organizata joqeveritare kosovare, shumica prej të cilave kishin përvojë të mëhershme në monitorimin e zgjedhjeve. Demokracia në Veprim mbështetë promovimin e zgjedhjeve të lira si pjesën më thelbësore për një shoqëri demokratike. Objektivi kryesor i Demokracisë në Veprim është sigurimi i një procesi zgjedhor sipas standardeve universale për zgjedhje të lira të drejta dhe të barabarta dhe vëzhgim të paanshëm të procesit zgjedhore që inspiron besim tek qytetarët. Përmes pjesëmarrjes së shoqërisë civile ky koalicion promovon: pjesëmarrjen në zgjedhje të lira përmes edukimit të votuesve, promovon të drejtën dhe obligimin e qytetarëve që të jenë pjesë e procesit zgjedhor, bashkëpunon me organizata vendore, rajonale dhe ndërkombëtare për ndërtimin e një procesi transparentë dhe vëzhgim të procesit në mënyrë të paanshme si kontribut në avancimin e jetës demokratike në Kosovë.

Copyright ©2021 . Demokracia në Veprim (DnV).

Demokracia në Veprim (DnV) i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
Web: <http://www.demokracianeveprim.org>

Layout and design: **envinion**

Përmbajtja



HYRJE DHE
KONTEKST POLITIK **7**



FUSHATA
ZGJEDHORE **23**



SISTEMI
ZGJEDHOR
LOKAL **9**



FINANCIMI I
SUBJEKTEVE
POLITIKE **29**



ORGANIZIMI DHE
ADMINISTRIMI I
ZGJEDHJEVE **13**



PËRFSHIRJA
E GRAVE **33**




VOTIMI JASHTË
KOSOVËS **19**



MEDIAT DHE
ZGJEDHJET **37**

1. Hyrje dhe kontekst politik



Kosova do të organizojë më 17 tetor të këtij viti procesin e tretë të rregullt zgjedhor për institucionet e nivelit lokal, që nga shpallja e pavarësisë. Këto zgjedhje u shpallën nga Presidentja e vendit më 15 qershor, brenda afateve të paracaktuara ligjore pas konsultave me subjekteve politike, si dhe zhvillimeve dramatike në raport me KQZ-në, që kulmuan me shkarkimin e ish-kryesueses së KQZ-së, Valdete Daka, si dhe emërimit të kryesuesit të ri, Kreshnik Radoniqi, vetëm një ditë para shpalljes së këtyre zgjedhjeve.

Zgjedhjet e 17 tetorit do të organizohen në një kontekst politik pothuajse të transformuar plotësisht krahasuar me zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017. Si rezultat i procesit zgjedhor të 14 shkurtit, Kosova tashmë qeveriset nga Lëvizja Vetëvendosje që si subjekt i vetëm politik arriti të fitojë mbi 50% të votave në zgjedhjet e 14 shkurtit.


Përkundër disa problemeve të evidentuara e të përsëritura në pothuajse secilin proces zgjedhor, Kosova ka shënuar një përparim esencial në kapacitetet për të organizuar dhe administruar proces me rregullsi zgjedhore, që garantojnë në masë të madhe kredibilitet të procesit, si dhe besueshmëri të publikut në përfundimet zgjedhore.

Sa i përket situatës me pandeminë COVID-19, aktualisht Kosova bën pjesë në grupin e shteteve me situatë dukshëm të relaksuar epidemiologjike dhe parametra pozitivë. E në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 14 shkurtit, situata me pandeminë kishte qenë ndër faktorët që kishin determinuar mënyrën

e të bërit fushatë, zhvillimet në ditën e votimit por në përgjithësi edhe të vet procesit zgjedhor.

Me anë të këtij punimi, "Demokracia në Vepërim" (DnV), duke ndjekur një qasje më proaktive, ka për synim të ofrojë rekomandime për palët e involvuara në zgjedhje në mënyrë që ato të shmangin përsëritjen e parregullësive zgjedhore që janë evidentuar nga raportet paraprake të vëzhgimit të zgjedhjeve. Këto rekomandime bazohen në vlerësimet e dy palë zgjedhjeve lokale të vitit 2017 dhe 2013 dhe synojnë të përafrojnë administrimin e zgjedhjeve në Kosovë me standardet më të larta ndërkombëtare.

2. Sistemi zgjedhor lokal



Edhe këto zgjedhje lokale e gjejnë Kosovën me një kuadër të pandryshuar ligjor, si rezultat i mungesës së një procesi të reformës zgjedhore. Ligji për Zgjedhjet Lokale e përcakton secilën nga 38 komunat e Kosovës si zonë të veçantë zgjedhore, në të cilat organizohen njëkohësisht zgjedhje për kuvendin komunal dhe zgjedhje për kryetarin e komunës përkatëse. Për këtë të fundit, është paraparë edhe organizimi i raundit të dytë, në rast se në raundin e parë asnjë prej kandidatëve nuk arrin të fitojë më shumë se 50%, plus një votë nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme. Ndërsa, organizimi dhe administrimi teknik e procedural i zgjedhjeve bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Përkundër thjeshtësisë në dukje të sistemit zgjedhor lokal, i njëjti ka prodhuar disa anomali, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate as në diskursin publik, por as në mesin e akterëve relevantë. Ndër problemet më akute mbetet përfundimi i parakohshëm i mandateve të kryetarëve të komunave, qoftë si rezultat i problemeve të tyre me ligjin apo edhe dorëheqjeve për shkaqe të ndryshme. Që nga zgjedhjet e para lokale (2009) pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ka kaluar në plot 13 procese të jashtëzakonshme zgjedhore vetëm për të parin e komunës, pa përfshirë edhe raundet e dyta të votimeve që kanë ndodhur në katër prej këtyre proceseve të jashtëzakonshme zgjedhore.

Së dyti, balotazhet vijnë të karakterizojnë procesin zgjedhor në një pjesë të konsiderueshme të komunave. Në vitin 2017, më shumë se gjysma, përkatësisht 20 komuna, kanë organizuar raunde të dyta të votimit. Ndërsa, në vitin 2013 numri i komunave që kishin raund të dytë të votimit ishte edhe më i madh, me plot 25 komuna që patën balotazh. Edhe pse parimisht organizimi i raundeve të dyta nuk është në vetvete problematik, krijimi i koalicionëve shpesh joformale mes kandidatëve – kryesisht të panatyrshme dhe jo mbi baza programore – ka ngritur dilema mbi mundësinë e “deformimit” të vullnetit real qytetar. Kësaj i shtohet fakti që zakonisht këto koalicionë janë në dëm të kandidatit të parë në raundin fillestar, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin zgjedhor të raundit të dytë. Në vitin 2017, nga 20 komuna që kanë shkuar në balotazh, në 6 prej tyre¹ ka pasur përmbysje të rezultatit krahasuar me raundin e parë, madje edhe në raste kur në raundin e parë kandidati fitues ka pasur diferencë prej gati dyfishin e votave me kandidatit të dytë. Kurse, në vitin 2013, numri i komunave ku ka pasur përmbysje të rezultatit nga 25 komunat ku kishte balotazh, është plot 8 sosh².

¹ Dragash, Klinë, Mitrovicë e Jugut, Prizren, Vushtrri dhe Klllokot.

² Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Prishtinë, Ferizaj dhe Partesh.

Rekomandimet

- 1 Subjektet politike të arrijnë marrëveshje dhe koalicione parazgjedhore në mënyrë që kandidaturat të jenë rezultat i koalicioneve programore e jo të bazuara në pazare pas raundit të parë zgjedhor



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

- 2 Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligji për Zgjedhjet lokale duhet të ndryshohen për të mundësuar garimin në pako të kryetarit dhe nënkryetarit të komunës, duke paraparë vazhdimin e mandatit të kryetarit nga nënkryetari (nëse ka kaluar më shumë se gjysma e mandatit)



Për kë?


Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

3. Organizimi dhe administrimi i zgjedhjeve



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka avancuar ndjeshëm në organizimin dhe administrimin e të gjitha operacioneve zgjedhore, kryesisht edhe si rezultat i përvojës në organizimin e shpeshtë të zgjedhjeve, madje edhe në afate jashtëzakonisht të shkurtra. Mes tjerash, KQZ ka ngritur progresivisht nivelin e transparencës ndaj publikut, si dhe ka arritur një standard të kënaqshëm në paraqitjen e rezultateve në kohë të shpejtë, duke ndikuar në rritjen e besimit të publikut.

Shumica e parregullsive që evidentohen gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve janë rezultat i trajnimeve jocilësore dhe joadekuatë të komisionerëve. Po ashtu, si rezultat i trajnimeve të tilla, sidomos në raport me procesin e numërimit, kemi një përqindje të madhe të vendvotimeve të cilat rinumërohen sërish në QNR. Konstatime të tilla janë të bazuara në monitorimin nga DnV-ja por edhe EUEOM, të këtyre trajnimeve në zgjedhjet e vitit 2017 dhe atyre të vitit 2013. Edhe pse materialet e trajnimeve kanë shënuar avancime nga procesi në proces, integriteti i komisionerëve dhe kriteret minimaliste që kërkohen për të qenë në këtë pozitë lë shumë për të dëshiruar, fajin parësor lidhur me çka e kanë vet subjektet politike minuese.

Përkundër vlerësimeve pozitive për punën e institucioneve për administrimin e zgjedhjeve, në këtë rast KQZ-së, ndër fenomenet që kanë përcjellë punën e saj ka qenë politizimi i një pjese të konsiderueshme të çështjeve të trajtuara nga ky institucion. Përplasjet e para kishin filluar qysh në zgjedhjet e vitit 2013, atëbotë si rezultat i problemeve me orga-

nizimin e zgjedhjeve në katër komunat veriore, bazuar në marrëveshjen e arritur mes Kosovës dhe Serbisë po atë vit. Shndërrimi i KQZ-së në arenë debatesh të ashpër dhe përplasjesh mes anëtarëve kishte vazhduar edhe në zgjedhjet e vitit 2017, ndonëse në përmasa më të vogla, ku çështje kryesore e diskutimit ishte certifikimi i kandidatëve. Problem tjetër persistent i punës së KQZ-së dhe KKZ-ve është mosmbajtja e rregullt e mbledhjeve.

Problematikë tjetër sistematike e KQZ-së janë fushatat për informim dhe edukim të votuesve, që si komponentë ndërlidhet edhe me numrin shumë të madh të fletëvotimeve të pavlefshme dhe problemet e qytetarëve në gjetjen e emrit në listat e votuesve. Fushatat e KQZ-së janë cilësuar vazhdimisht si të dobëta, të patargetuara, me përmbajtje shabllone, e mbi të gjitha si të vonuara – për shkak të problemeve të shpeshta me procedurat e prokurimit. Në zgjedhjet lokale të vitit 2013 ishin shënuar mbi 70 mijë fletëvotime të pavlefshme vetëm për zgjedhjet për kuvendet komunale, ndërsa edhe mbi 15 mijë fletëvotime tjera të pavlefshme në zgjedhjet për kryetarë të komunave. Përkundër natyrës së fletëvotimeve të pavlefshme – ku nuk shënohej subjekti politik por vetëm kandidati – që indikon si shkaktar të drejtpërdrejtë cilësinë e fushatave për informim dhe edukim të votuesve, KQZ-ja nuk është se ka ndërmarrë shumë hapa për t'a adresuar këtë çështje. Si rezultat, edhe pse me një rënie fare të lehtë, në zgjedhjet lokale të vitit 2017 ishin evidentuar sërish afro 80 mijë fletëvotime të pavlefshme.

Me përjashtim të zgjedhjeve të fundit parlamentare të 14 shkurtit, në proceset e kalu-

ara zgjedhore, sidomos atyre të nivelit lokal, ka pasur përpjekje minimale për pastrimin e listave zgjedhore, në të cilat ende ka një numër të madh të qytetarëve të vdekur. Problem tjetër që shpërfaqë pasaktësinë e listës së votuesve është edhe mospërputhja e vendbanimit të votuesve me qendrën më të afërt të votimit, që për pasojë, në ditën e zgjedhjeve ka bërë që të evidentohen dhjetëra-mijëra raste të pamundësisë së votuesve për të gjetur vend-votimin e saktë. Janë të shpeshta edhe rastet e paqartësisë në relacion me dokumentet e vlefshme që mund të përdoren për të votuar, sidomos ato me afat të skaduar.

Votimi me kusht, edhe pse i paraparë me ligj, si mënyrë e votimit tashmë është i vjetërsuar dhe i panevojshëm. Në secilin prej dy proceseve zgjedhore lokale, 2017 dhe 2013, janë evidentuar mbi 10 mijë vota me kusht, të cilat kanë pasur ndikim edhe në vonesat në certifikim të rezultateve.

Çështje tjetër të cilës nuk i është kushtuar vëmendja e nevojshme është edhe qasja e personave me aftësi të kufizuara në votim. Për shkak të përdorimit të përgjithësisht të njëjtave qendrave të votimit, nuk është shënuar pothuajse fare progres në ofrimin e qasjes fizike për personat me aftësi të kufizuara në qendra të votimit. Rreth 1/3 e të gjitha qendrave të votimit nuk ofrojnë qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara fizike. Madje, këtyre personave e drejta e votimit u cenohet fundamentalisht në rastet kur shkollat janë dy apo më shumë katëshe, e në të cilat mungon ashensori.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka avancuar ndjeshëm në organizimin dhe administrimin e të gjitha operacioneve zgjedhore, kryesisht edhe si rezultat i përvojës në organizimin e shpeshtë të zgjedhjeve, madje edhe në afate jashtëzakonisht të shkurtra. Mes tjerash, KQZ ka ngritur progresivisht nivelin e transparencës ndaj publikut, si dhe ka arritur një standard të kënaqshëm në paraqitjen e rezultateve në kohë të shpejtë, duke ndikuar në rritjen e besimit të publikut.

Rekomandimet

1

KQZ-ja të përcaktojë kalendarin e takimeve në përputhje me nenin 13.1 të Rregullores së Punës



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

2

Kryesuesi i KQZ-së duhet t'a mbajë nivelin e debatit brenda margjinave profesionale, si dhe të mos lejojë diskutime që nxisin përplasje mes anëtarëve tjerë



Për kë?

Kryesuesi i KQZ-së



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

3

KQZ të zhvillojë fushata të informimit dhe edukimit që janë të targetuara dhe të përshtatura për grupe të caktuara demografike



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

4

Fushatat e KQZ-së të kenë fokus edukimin e votuesve mbi mënyrën e votimit në zgjedhje lokale e cila ndryshon nga zgjedhjet parlamentare



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

Rekomandimet

5

KQZ të ndryshojë dizajnin e fletëvotimeve për zgjedhje lokale, duke marrë për bazë dizajnin e testuar dhe propozuar nga KDI



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

6

KQZ të vijojë me punën drejt pastrimit të listave të votuesve nga personat e vdekur



Për kë?

Kryesuesi i KQZ-së



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

7

KQZ të ofrojë instruksione të pandryshueshme mbi identifikimin e votuesve me dokumente me afat të skaduar



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

8

Subjektet politike të nominojnë për komisionerë persona të kualifikuar dhe me integritet, duke zbatuar parimin e barazisë gjinore edhe në rekrutim



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

Rekomandimet

9

Trajnimet për anëtarët e KVV-ve duhet të jenë më cilësore, duke i testuar në mënyrë më rigoroze njohuritë e fituara të komisionerëve. Përmbajtja e trajnimeve duhet të reflektojë edhe seriozitetin e problemeve në elemente të caktuara, sidomos në numërim dhe plotësim të formularëve të rezultateve



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

10

KQZ të krijojë "lista të zeza" të komisionerëve bazuar në performancën e tyre



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

11

KQZ të sigurojë që të gjitha qendrat e votimit dhe vendvotimet ofrojnë infrastrukturë të përshtatshme fizike, për qasje të personave me aftësi të kufizuara fizike. Ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara fizike duhet të jetë kriter i përzgjedhjes së qendrës së votimit nga KQZ-ja.



Për kë?


KQZ



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

4. Votimi jashtë Kosovës



Operacioni mbase më i ndjeshëm dhe i diskutuar në kuadër të zgjedhjeve është votimi jashtë vendit. Votimi jashtë Kosovës është ballafaquar me një sërë situatash dhe problematikash, që shpeshherë kanë cenuar vet integritetin e zgjedhjeve. Fillimisht, gjatë vitit 2013, administrimi i këtij procesi bëhej nga KQZ-ja, me përjashtim të votimit që bëhej në Serbi dhe Mal të Zi – i cili administrohej faktikisht nga OSBE-ja, që ishte përgjegjëse për transportimin e këtyre votave për në Kosovë. Ky proces në atë kohë nuk ishte administruar brenda standardeve dhe kornizës ligjore, kryesisht edhe për shkak të karakterit të ndjeshëm politik të saj. Problemet kryesore ishin shfaqur në regjistrimin e votuesve, pranimin e fletëvotimeve dhe trajtimin e ankësive zgjedhore pranë PZAP-së dhe Gjykatës Supreme.

Edhe në zgjedhjet lokale të vitit 2017 votimi jashtë Kosovës doli të jetë përgjithësisht i parregullt e me shumë mangësi, që ishin përsëritje e problemeve të zgjedhjeve të vitit 2013. Madje, kësaj here u vërtetuan pretendimet për manipulim të këtij operacioni, që kishte bërë që të përsëritet raundi i dytë i votimit në komunën e Istogut, si dhe raundi i parë në komunën e Klllokotit. Rivotimi kishte ndodhur për shkak të vërtetimit të manipulimit të votimit jashtë vendit në atë mënyrë që ndikohej drejtpërdrejtë rezultati përfundimtar zgjedhor. Konkretisht, pas një hetimi të PZAP-së, ishte konstatuar se një pjesë e konsiderueshme e numrave të telefonit ishin të rrejshëm, e që për rrjedhojë nënkuptonte se është aplikuar kundërligjshëm në emër të personave tjerë, si dhe një pjesë e votuesve të

regjistruar dhe që kishin votuar ishin persona të vdekur, që kishin edhe certifikata të vdekjes. Gjegjësisht, vetëm 85 nga 1,587 votuesit e konfirmuar në kuadër të votimit jashtë vendit për komunën e Istogut rikonfirmuan statusin e tyre për rivotimin në atë komunë. Në këtë kontekst, votimi jashtë vendit ishte i një rëndësie të veçantë edhe për shkak të diferencës së ngushtë mes kandidatëve, veçanërisht gjatë raundeve të dyta të votimit. Madje, këto vota në disa raste ishin edhe përcaktuese të fituesit.

Votimi jashtë vendit ishte çështje problematike edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, ndonëse në dy dimensione tjera. Së pari, aspekti i parë kontestues ishte pranimi i pakove me fletëvotime pas afatit të përcaktuar ligjor prej 24 ore para ditës së zgjedhjeve. Si rezultat i ardhjes me vonesë së disa mijëra pakove me fletëvotime të supozuara në fahun postar të KQZ-së, kishte pasur një “ping-pong” të vendimeve mes PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, me të parën që kishte vendosur për mospranimin e tyre, e me të dytën që shfuqizonte praktikisht disa nene të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që rregullojnë votimin jashtë vendit, duke u thirrur në Protokollin 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me vendimet e Gjykatës Supreme, si instanca e fundit, ishte përcaktuar që edhe votat jashtë afatit duhet të numërohen dhe të jenë pjesë e rezultatit zgjedhor. Sidoqoftë, kjo çështje ishte adresuar përmes një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, i cili kishte përcaktuar që votat e ardhura pas afatit ligjor nuk mund të pranoohen dhe të jenë pjesë e rezultatit përfundimtar.

Së dyti, probleme me votimin jashtë vendit ishin shfaqur sërish në raport me votat e ardhura nga Serbia, të cilat ishin apostrofuat vazhdimisht si vota të manipuluar, për shkak se pothuajse 100% e tyre ishin në favor të një subjekti të vetëm politik, si dhe për kandidatë të njëjtë. Fillimisht, gjatë verifikimit të pakove të ardhura nga Serbia ishin shfaqur probleme shëndetësore, të pretenduara si helmim, tek mbi 20 punonjës të KQZ-së, duke bërë që procesi të pezullohet për 10 ditë, para se i njëjti të përmbyllet në masa të rrepta sigurie – duke u ofruar kostume speciale stafit të KQZ-së. Përkundër involvimit të Prokurorisë Speciale të Kosovës në këtë rast, ende nuk ka një version zyrtar të asaj se çfarë ka ngjarë me ato pako. Tutje, votat e ardhura nga Serbia ishin sfiduar ligjërisht edhe nga aspekti procedural i ardhjes së tyre, me PZAP-në e cila kishte konstatuar se sjellja e pakove të votimit nga persona fizik në fahun postar të KQZ-së, pa një vulë nga posta dërguese paraqet shkelje ligjore. Po ashtu, përmes këtij vendimi të PZAP-së ishte kontestuar edhe praktika e mëparshme e pranimit të votave të ardhura nga Serbia që nga viti 2013, për të cilën ishte konstatuar që nuk ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Si për të mos mjaftuar këto çështje, votimi jashtë vendit ishte problematizuar edhe në zgjedhjet parlamentare të këtij fillim viti. Duke marrë parasysh mungesën e mekanizmave të sigurisë në kuadër të këtij operacioni, KQZ-ja kishte nxjerrë vendim, përkatësisht udhëzim administrativ për verifikimin përmes telefonit të aplikacioneve për votim jashtë vendit. Ky vendim kishte ngjallur reagime të

shumta dhe kishte nxitur përplasje të ashpra mes anëtarëve të KQZ-së. Madje, kjo çështje ishte listuar si një nga arsytet e shkarkimit të ish-Kryesueses së KQZ-së, Valdete Daka, nga Presidentja Osmani. Megjithatë, për shkak edhe të presionit publik, së fundmi KQZ-ja ka ndryshuar vendimin dhe udhëzimin përkatës administrativ, duke shfuqizuar dispozitat paraprake që parashihnin verifikimin e të gjithë aplikuesve. Me udhëzimin e ri, ndonëse masa e verifikimit përmes telefonit si qasje mbetet e njëjtë, përcaktohet një numër dukshëm më i vogël i aplikacioneve që do të verifikohen, duke përfshirë një mostër të rastësishme prej 2% të aplikacioneve të pranuar, si dhe rastet kur një numër i njëjtë i telefonit dhe një e-mail adresë e njëjtë përdoret në më shumë se një aplikacion. Çështje tjetër problematike në kuadër të këtij votimi është hapësira e kufizuar kohore që kanë në dispozicion qytetarët për të ankmuar vendimet tek instancat përkatëse.

Rekomandimet

1

Votimi jashtë Kosovës të rishikohet ligjërisht, duke përcaktuar qartazi procedurat dhe të drejtën e aplikimit për qytetarët jashtë vendit



Për kë?

Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

2

Përmes ndryshimeve ligjore të përcaktohet zhvillimi dhe funksionalizimi i një aplikacioni online për regjistrimin e votuesve jashtë vendit, që përmban mekanizma të sigurisë



Për kë?


Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

5. Fushata zgjedhore



Duke qenë procese të rregullta, zgjedhjet lokale karakterizohen nga një periudhë më e gjatë e fushatës zgjedhore që është 30 ditë. E megjithatë, fushata reale në terren fillon shumë kohë më parë, zakonisht qysh në ditët e para pas shpalljes së zgjedhjeve apo caktimit të kandidaturave, siç edhe jemi duke parë aktualisht. Deri në zgjedhjet e fundit, gjatë së cilave për shkak të pandemisë COVID-19 ishte imponuar kufizime në mënyrën e të bërit fushatë, zakonisht kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarë ishin mbizotëruese si forma të takimit, qoftë në takime publike, vizita derë më derë, vizita nëpër objekte private e të ngjashme. Ndërsa, përdorimi i rrjeteve sociale dhe fushatës 'online' është duke gjetur përherë e më shumë zbatim në terren. Tashmë është shënuar avancim i ndjeshëm në raport me vendosjen e materialeve propaganduese në hapësira të ndaluara, ku rol të madh kanë pasur edhe organizatat e shoqërisë civile, sidomos DnV-ja, që me paraqitjen e lëndëve pranë PZAP-së e cila zakonisht ka marrë vendime ndëshkuese për subjektet politike, ka arritur që t'i disiplinojë këto të fundit. Sidoqoftë, imazhi, mbarëvajtja dhe përgjithësisht fryma konkurruese e fushatës është cenuar vazhdimisht në pjesën veriore të vendit, si në dy palë zgjedhjet e fundit lokale, por edhe zgjedhjet tjera parlamentare. Ajo pjesë është karakterizuar vazhdimisht me incidente, kërcënime e intimidime si dhe raste të dhunës, zakonisht në dëm të subjekteve që kanë garuar kundër Listës Serbe. Prania dhe ndikimi i drejtpërdrejtë i zyrtarëve shtetëror serb ka penguar shprehjen e vullnetin e lirë dhe preferencave të qytetarëve.

Vëzhgimi i përditshëm i fushatës zgjedhore nga DnV, me mbi 60 vëzhgues afatgjatë ka mundësuar një pasqyrë të qartë të asaj se çfarë ndodhë në terren dhe si sillen subjektet politike. Gjatë 30 ditëve të fushatës në zgjedhjet lokale ka qenë e zakonshme të dëgjohen premtime nga më të ndryshmet, përfshirë edhe ato për të cilat komuna nuk ka as kompetencë e as buxhet për t'i realizuar. Fushata në ciklet e kaluara zgjedhore është karakterizuar me premtime të ofruara nga kryetari i subjektit politik në emër të kandidatit për kryetar, duke i anashkaluar pothuajse tërësisht kandidatët për kuvendet komunale. Karakteristikë e fushatave, sidomos atyre në zgjedhje lokale është përdorimit i narracioneve që shpërfaqin rivalitetet politike. Po ashtu, tipike është përsëritja e premtimeve nga zgjedhjet në zgjedhje, shpeshherë si rezultat i mosrealizimit të tyre, apo mosdaljes nga formati i premtimeve shabllone – që në shumë raste nuk reflektojnë pritshmëritë qytetare.

Mitingjet kanë qenë forma më e preferuar e subjekteve politike për të bërë fushatë. E megjithatë, gjatë këtyre tubimeve janë hasur fjalime që përmbajnë gjuhë të urrejtjes kundrejt subjekteve tjera politike apo kandidatëve të caktuar. Parregullsi të tjera që i përcjellin fushatat e subjekteve politike në Kosovë janë përdorimi i resurseve publike, mosraportimi i takimeve në institucionet përkatëse, përfshirja e fëmijëve në mënyrë të organizuar në fushatë zgjedhore problematike e evidentuar në 30% të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara nga DnV gjatë 2017-së.

Rekomandimet

1

Subjektet politike, sidomos ato që kanë pushtet në nivelin qendror apo atë lokal në komuna të caktuara, të mos përdorin resurset publike për qëllime të fushatës



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

2

Subjektet të heqin dorë plotësisht nga përdorimi i grupeve të organizuara të fëmijëve në aktivitetet e fushatës, në çfarëdo forme të angazhimit



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

3

Subjektet politike dhe kandidatët e tyre të mos hezitojnë të jenë pjesë e debateve publike me kundërkandidatët e tyre, duke u mundësuar një numri më të madh të qytetarëve qasje në platformat dhe premtimet përkatëse.



Për kë?

Subjektet politike dhe kandidatët e tyre



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

4

Subjektet politike dhe kandidatët e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës së urrejtjes, si gjatë krijimit të përmbajtjes dhe materialeve të fushatës zgjedhore, ashtu edhe nëpër mediat sociale



Për kë?

Subjektet politike dhe kandidatët e tyre



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

Rekomandimet

5

Kryetarët e subjekteve politike të përfshihen në fushatë vetëm deri në atë masë sa nuk minojnë rolin e kandidatit për kryetar apo kandidatëve për kuvendet komunale



Për kë?

Kryetarët e subjekteve politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

6

Në komunitet me shumicë serbe, sidomos në katër komunitet veriore, të garantohet e drejta e secilit qytetar dhe kandidat për të shprehur lirshëm vullnetin e tij. Gjatë periudhës së fushatës të mos lejohen interferime të jashtme që cenojnë frymën e garës së barabartë.



Për kë?

Institucionet e sigurisë dhe ato të drejtësisë



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

7

Subjektet politike të ndërtojnë platforma të qarta e konkrete për adresimin e problemeve të qytetarëve, dhe t'i publikojnë ato në formate të shkruara apo online. Platformat nuk duhet të përfshijnë çështje që nuk janë kompetencë e komunave



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

Rekomandimet

8

Subjektet politike të organizojnë fushata "miqësore me mjedisin", pa përdorim të letrës, plastikës dhe produkteve tjera të dëmshme për mjedisin



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

9

Subjektet politike të njoftojnë mbajtjen e aktiviteteve zgjedhore pranë KKZ-ve



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

10

Të sigurohet organizimi i një fushate të sigurt, në respektim të masave mbrojtëse kundër COVID-19



Për kë?

Subjektet politike, Policia e Kosovës dhe inspektoratet komunale



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

11

Periodha e parafushatës të rregullohet me ligj, në atë mënyrë që edhe shpenzimet e asaj periudhe të jenë pjesë e tavanit të shpenzimeve që përcaktohet nga KQZ



Për kë?


Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

6. Financimi i subjekteve politike



Fushatat zgjedhore qoftë në nivel lokal apo qendror krijojnë shpenzime për subjektet politike garuese por edhe për kandidatët që garojnë për deputet apo kryetar komunash. Subjektet politike kanë të drejtë të shpenzojnë 0.50 euro cent për votues, apo afër 1 milion euro për një fushatë zgjedhore. Sipas ligjit, subjektet politike obligohet ta raportojnë tek KQZ (Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim) secilën të hyrë dhe shpenzim që bëhet para, gjatë dhe pas fushatës. Në anën tjetër ligji nuk parasheh një obligim të ngjashëm për kandidatët për deputet, kryetarë komunash apo anëtarë të kuvendeve komunale, që të njëjtit të ndërmarrin ndonjë veprim për raportimin e të hyrave dhe shpenzimeve të tyre në kohë fushate. Ky mosraportim, përpos që afekton transparencën e procesit, ndikon drejtpërdrejtë në parimin e garës së barabartë, po ashtu përket në shkelje të vazhdueshme të tavanit të shpenzimeve nga ana e subjektit politik. Nga anketat e vazhdueshme me subjektet politike, të cilat KDI i ka realizuar para fillimit të fushatave zgjedhore, na del se shumica e subjekteve politike janë jo transparente në dy drejtime fillimisht sa i përket mënyrës së financimit dhe shpenzimit të parave gjatë fushatës dhe më pas edhe mënyrës së shpërndarjes së parave në nivel të degëve apo kandidatëve.

Nga krahasimi i thjeshtë i asaj që Demokracia në Veprim e ka vëzhguar dhe më pas raportuar gjatë fushatave zgjedhore, gjejmë një shpërputhje goxha e madhe në mes shpenzimeve reale dhe atyre të deklaruara për KQZ-në apo publikun.

Ambiente luksoze, salla të mëdha sportive, restorante të shtrenjta, rekuizita, bina dhe këngëtar, zërim e ndriçim, autobus e makina, spote reklamuese e reklama në rrjete sociale, janë vetëm disa nga shpenzimet që DnV ka arritur ti llogarisë me çmimet e tregut dhe përfundimi del se shpenzohet shumë më shumë se sa raportohet.

Rekomandimet

- 1** Kandidatët t'i paraqesin shpenzimet e tyre të fushatës në kohë reale, si vlerë e shtuar e procesit. Kandidatët duhet që shpenzimet dhe të hyrat t'i paraqesin edhe për periudhën e parafushatës



Për kë?

Kandidatët e subjekteve politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

- 2** KQZ të ndërmarrë veprime të shpejta kundrejt subjekteve politike që nuk raportojnë saktë shpenzimet dhe financimin gjatë fushatës zgjedhore



Për kë?

KQZ



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

- 3** Përmes ndryshimeve ligjore të përcaktohet obligimi edhe i kandidatëve që të raportojnë të hyrat dhe shpenzimet gjatë fushatave zgjedhore, si pjesë integrale e raporteve financiare të subjekteve politike



Për kë?

Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

- 4** Përmes ndryshimeve ligjore të përcaktohet obligim për subjektet politike që të hapin llogari të veçanta bankare për periudhën e fushatës



Për kë?

Kuvendi i Kosovës



Mund të adresohen...

Pas zgjedhjeve lokale

7. Përfshirja e grave



Ndonëse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së Kosovës, si dhe faktit që gratë kanë trendë të daljes në zgjedhje lokale më të larta se burrat, kjo nuk është përkthyer në njësoj edhe në numrin e grave që janë zgjedhur si kryetare apo anëtare të kuvendeve komunale. Aktualisht, gratë janë të nën-përfaqësuar në institucionet e zgjedhura në nivelin lokal, me vetëm 35% në kuvende komunale, ndërsa asnjë grua nuk bart pozitën e kryetares së komunës – me vetëm një rast në zgjedhjet lokale të organizuara në vitin 2013, kur një grua ishte zgjedhur kryetare. Në zgjedhjet e vitit 2017, vetëm në 10 nga 38 komunat kishte bartëse të listave gra, me gjithsej vetëm 13 gra bartëse të listave gjithsej. Një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë arritur që të zgjidhen fare. Situata më e mirë, por sërish shumë nën standardin e dëshiruar, ishte edhe në zgjedhjet e vitit 2013. Prej gjithsej 38 komunave, në 16 prej tyre ka pasur gra si bartëse të listave, përkatësisht 25 sosh gjithsej.

Në anën tjetër, sa i përket kandidaturave të grave për të parën e komunës, përkatësisht zgjedhjen e tyre, situata është dukshëm më e degraduar. Në zgjedhjet e vitit 2017, vetëm në gjashtë komuna³ ka pasur kandidate gra, numri i përgjithshëm i së cilave ishte tetë sosh – prej të cilave vetëm dy arritën të shkonin në balotazh. Asnjë prej tyre nuk kishte arritur të fitojë postin e të parës së komunës. Kurse, në vitin 2013, numri i komunave ku kishte kandidate gra ishte shtatë⁴, me vetëm nëntë gra kandidate nga 224 kandidatë gjithsej. Prej tyre, vetëm Mimoza Kusari-Lila kishte arritur

të zgjidhej kryetare e Gjakovës. Ndërsa, sa i përket kandidaturave për anëtare të kuvendeve komunale, subjektet politike zakonisht janë mjaftuar me respektimin strikt të kriterit minimal ligjor prej 30%.

Numri i vogël i grave kandidate ka pasur raport pothuajse ekuivalent edhe me hapësirën që grave u është ofruar në fushata zgjedhore. Zakonisht, pjesëmarrja e grave në aktivitete të fushatës zgjedhore është marginale, që sillet rreth vetëm 10% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve si audience, ndërsa rreth 20% në cilësinë e folëseve. Madje, as programet e subjekteve politike nuk përfshijnë gati asnjë politikë specifike në funksion të rritjes së përfshirjes dhe pjesëmarrjes së grave në politikë por edhe jetën publike në përgjithësi. Njësoj veprojnë edhe mediumet tradicionale, të cilat ofrojnë fare pak hapësirë për kandidatet gra.

Një situatë e tillë e mospërfshirjes së grave ndërlihet me aspektin financiar, përkatësisht buxhetin tejte të mangët që ofrohet në dispozicion të tyre, duke i vendosur kështu gratë në pozitë të disfavorshme krahasuar me kandidatët burra.

3 Gjakovë 1, Drenas 1, Mitrovicë e Jugut 1, Pejë 2, Prizren 1, Hani i Elezit 1 dhe Mitrovicë e Veriut 1.

4 Gjakovë 2, Gjiilan 1, Istog 2, Kaçanik 1, Prishtinë 1, Skenderaj 1 dhe Mitrovicë e Veriut 1.

Në mungesë të kuotave për gratë në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve, përfshirja e grave në to mbetet e ulët. Në zgjedhjet e vitit 2013 vetëm 12%, apo 35 gra gjithsej, ishin pjesë e KKZ-ve në nivel lokal. Ndërsa, në KVV pjesëmarrja e grave si anëtare ishte 17.5% ndërsa si kryesuese vetëm 9%. Në zgjedhjet e vitit 2017 ishte shënuar progres në lidhje me përfshirjen e grave në trupa menaxhuese të zgjedhjeve, ndonëse jo në shkallën e dëshiruar dhe në shpërputhje me vet deklaratën e nënshkruar nga subjektet kryesore politike që përcaktonin kuotë vullnetare të grave prej 40% nëpër trupa menaxhuese të zgjedhjeve⁵. Prania e grave si komisionerë në 2017 ishte diç më pak se 30%, ndërsa dukshëm më pak në cilësinë e kryesueseve të këshillave vendvotimeve.



Aktualisht, gratë janë të nën-përfaqësuar në institucionet e zgjedhura në nivelin lokal, me vetëm 35% në kuvende komunale, ndërsa asnjë grua nuk bart pozitën e kryetares së komunës – me vetëm një rast në zgjedhjet lokale të organizuara në vitin 2013, kur një grua ishte zgjedhur kryetare.

⁵ Për më shumë, shih Deklaratën për rritjen e përfshirjes së grave në proceset zgjedhore. E qasshme në: <https://d4d-ks.org/aktivitetet/nenshkrimi-i-deklarates-per-rritjen-e-perfshirjes-se-grave-ne-proceset-zgjedhore/>

Rekomandimet

1

1. Subjektet politike t'u ofrojnë grave më shumë mundësi kandidimi për pozitën e kryetarit të komunës
2. Subjektet politike të zbatojnë modelin "zebër" të përfshirjes së grave në listat e kandidatëve, duke mos u mjaftuar me përmbushjen e kriterit minimal ligjor prej 30%
3. Subjektet politike të caktojnë më shumë gra si bartëse të listave zgjedhore



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

2

2. Subjektet politike të zhvillojnë politika specifike që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes dhe fuqizimit politik të grave dhe të njëjtat të jenë pjesë integrale e platformave të tyre.



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para dhe pas zgjedhjeve lokale

3

3. Subjektet politike të ofrojnë përkrahje të barabartë financiare për të gjithë kandidatët, dhe t'a bëjnë transparente mënyrën e shpërndarjes së tyre për kandidatet gra



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale,
gjatë fushatës zgjedhore

4

4. Subjektet politike t'i përmbahen zotimit të tyre për përfshirje të grave në nivelin prej 40% në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, e madje t'a avancojnë këtë përfshirje në proporcionin 50-50%



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

5

5. Mediat tradicionale duhet t'u ofrojnë mbulueshmëri më të madhe kandidateve gra, qoftë si kandidate për kryetare apo kandidate për kuvendet komunale



Për kë?

Mediat



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale,
gjatë fushatës zgjedhore

8. Mediat dhe zgjedhjet



Mediat shihen përgjithësisht si një prej formave më të zakonshme të të bërit fushatë në Kosovë, por edhe si mjet për përçimin e mesazheve politike tek qytetarët nga ana e subjekteve politike dhe kandidatët e tyre. Sidoqoftë, që nga zgjedhjet e fundit në Kosovë, mbase edhe për shkak të kushteve pandemike, shihet se fushatat kanë evoluar nga televizionet në shtrirjen e tyre në media sociale, prandaj është shtuar nevoja që edhe këto të fundit të monitorohen sistematikisht.

Skema mediale në Kosovë mbetet akoma jo në nivelin e duhur të përgatitjes për të zbatuar standardet më të larta etike, ligjore e profesionale qoftë në aspektin e rregullimit apo të funksionimit praktik të tyre. Kjo vjen në shprehje veçanërisht kur bëhet fjalë për pavarësinë editoriale dhe parandalimit të ndërhyrjes politike, e që janë parakushte kyçe për mbulim të pa-anshëm dhe të balancuar të fushatës parazgjedhore dhe të gjithë procesit zgjedhor.

Problemi kryesor i mediave gjatë fushatave zgjedhore vazhdon të jetë mos ofrimi i hapësirës për përfaqësim të barabartë gjinor. Nga monitorimi i bërë nga DnV në zgjedhjet e organizuara në Kosovë, shihet se ekziston një mungesë e madhe e përfaqësimit të barabartë për kandidatët e të dy gjinive gjatë fushatave. Në matjen e bërë për kronika zgjedhore, hapësira që kanë pasur gratë kandidate në kronikat zgjedhore është vetëm 5.6%, në krahasim me 94.4% për burrat. Edhe tek spotet televizive, që varen më shumë nga vet partitë, është evidente një diskrepancë e madhe në raport me përfaqësimin e barabartë gjinor. Vetëm 3% e spoteve kanë pasur mbulueshmëri për gratë

kandidate. Këtu përfshihen edhe tubimet që janë mbajtur, ku rrallëherë ka pasur gra kandidate që kanë mbajtur fjalime.

Tek sponsorizimet e spoteve në zgjedhjet e fundit janë hasur raste kur nuk është treguar se nga kush sponsorizohen të njëjtat, e madje në raste të caktuara nuk është ditur a ka qenë spoti i paguar apo jo. Kjo paraqet shkelje ligjore, dhe duhet të ketë një involvim më të madh të task-forcës për zgjedhje për të i ndëshkuar këto raste.

Komisioni i Pavarur i Mediave ka pasur rol pasiv në rastet e thyerjeve të heshtjeve zgjedhore. Edhe pse në disa raste vet mediat është dashur të dënohen, bashkë me partitë politike, nga KPM nuk ka pasur ndonjë reagim apo veprim konkret.

Rekomandimet

1

KPM të bëjë monitorim sistematik të mediave gjatë fushatës zgjedhore lidhur me respektimin e rregulloreve në fuqi



Për kë?

Komisioni i Pavarur i Mediave



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

2

KPM të monitorojë aktivitetin e subjekteve politike edhe në rrjete sociale, përfshijë rrjetet sociale në kuadër të monitorimit të saj



Për kë?

Komisioni i Pavarur i Mediave



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

3

KPM t'i njoftojë në kohë mediat lidhur me obligimet që rrjedhin ato kanë gjatë fushatës sipas rregulloreve në fuqi



Për kë?

Komisioni i Pavarur i Mediave



Mund të adresohen...

Para fushatës zgjedhore

4

KPM të standardizojë sanksionimin për mediat që kryejnë shkelje të natyrës së njëjtë



Për kë?

Komisioni i Pavarur i Mediave



Mund të adresohen...

Para dhe gjatë fushatës zgjedhore

Rekomandimet

5

KPM të publikojë rregullisht në ueb-faqen e saj vendimet për shqiptimin e sanksioneve, materialet e mbledhjeve, si dhe vendimet tjera



Për kë?

Komisioni i Pavarur i Mediave



Mund të adresohen...

Para zgjedhjeve lokale

6

Mediat të ofrojnë mbulueshmëri më të madhe mediale për kandidatet gra



Për kë?

Mediat



Mund të adresohen...

Gjatë fushatës zgjedhore

7

Subjektet politike t'u mundësojnë paraqitje më të madhe televizive grave që kandidojnë për kryetare komunash dhe anëtare të kuvendeve komunale



Për kë?

Subjektet politike



Mund të adresohen...

Para dhe gjatë fushatës zgjedhore



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action